

## MIRELA PITUSHI

**Datëlindja:** 16.08.1974

**Vendlindja:** Fier

**Email:** Mirela.Pitushi@parlament.al



### **Jetëshkrimi:**

Ka përfunduar studimet universitare në Menaxhim Biznes në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë. Ajo ka eksperiencë pune në sektorin privat dhe publik. Në sektorin privat ajo ka punuar si specialiste në firmën “Zeta shoes” (1997-2001). Në sektorin publik ajo ka punuar si operatore e më pas si ekonomiste në Drejtorinë Rajonale të Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor (2001-2018), drejtuese në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (2018-2021). Në periudhën 2013-2016, znj. Pitushi ka kryer praktikë të plotë pune pranë studios Eksperti Kontabël “Albanian Tax & Consulting” si asistente.

Znj. Pitushi ka kryer trajnime profesionale për organizimin e kontabilitetit praktik në njësinë e biznesit, legjislacionin tatimor, kontabiliteti i informatizuar- programi financa 5.0, teknikat e hartimit të bilancit dhe pasqyrave financiare. Po ashtu, ajo ka kryer trajnime në kuadër të projektit “Modernizimi i Asistencës sociale”.